

Çështja e identitetit kosovar

Donik Sallova*

Abstrakt

Me (ri)shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe themelimin e shtetit kosovar, në opinionin publik filluan të qarkullojnë ide se “meqë u krijua shteti i Kosovës, tani duhet të formohet edhe “kombi kosovar”, sepse çdo shtet duhet ta ketë identitetin e vet kombëtar të ndryshëm nga komb-shtetet e tjera”. Ky studim do të synojë të argumentojë se ideja e shtetit të Kosovës nuk ka lindur me synimin për të krijuar edhe identitetin e ri kombëtar të popullit të Kosovës (pra kombi kosovar), sepse identiteti kombëtar shqiptar i Kosovës ka qenë i formësuar. Sikurse, njësia politike jo domosdoshmërisht e përcakton apo e imponon edhe ndryshimin e identitetit kombëtar të një populli (qoftë edhe në rrethana okupimi). Në fakt, përpjekjet e kosovarëve për çlirim, pavarësi dhe ndërtim të shtetit kanë synuar mbrojtjen, garantimin dhe kultivimin e identitetit të tyre të formësuar kombëtar shqiptar i cili po u cenohej nga Serbia. Punimi do të argumentojë se ideja e “identitetit kosovar” si “identiteti i ri kombëtar i Kosovës” është më shumë një konstruksion artificial që shpërfillë rrethanat historike e politike të rrugës së shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, se sa aspiratë reale natyrore identitare e shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu, kjo ide bie në kundërshtim me parimet teorike të kombformimit modern në përgjithësi. Në fund do të konkludohet se shteti i Kosovës u projektua nga elita dhe populli i Kosovës si një shtet i dytë shqiptar, në pamundësi të përkohshme për bashkim me shtetin amë Shqipërinë, prandaj edhe “identiteti kosovar” përbën vetëm një sub-identitet shqiptar me karakteristika specifike dalluese, por që janë normale për të gjitha identitetet kombëtare moderne. Sikurse pengesë aktuale e përputhjes së natyrshme të identitetit shqiptar me shtetin kosovar mbeten “parimet ahtisaariane” të Republikës aktuale (Republika e 17 shkurtit), të cilat elita politike kosovare e pas vitit 2007 i pranoi si kompromis për “njohjen” e pavarësisë së Kosovës nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së (i cili përkundër pranimin të këtij kompromisi nuk e njohu shtetin e Kosovës).

Fjalë kyç: *identitet, komb, shtet, kosovar, shqiptar.*

* Donik Sallova, PhD. Candidate, Kolegji AAB, e-maili: donik.sallova01@gmail.com

Hyrje

Me (ri)shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe themelimin e shtetit kosovar, në opinionin publik filluan të qarkullojnë ide se “meqë u krijua shteti i Kosovës, duhet të formohet edhe “kombi kosovar”, sepse çdo shtet duhet ta ketë identitetin e vet kombëtar, të ndryshëm nga komb-shtetet e tjera”. Përhapja e kësaj ideje mori veçanërisht shkas nga fakti që (ri)shpallja e pavarësisë së Kosovës u bë duke u mbështetur në të ashtuquajturin “Propozim i Ahtisaarit”, i cili kishte përcaktuar premisat multi-etnike të shtetit të ardhshëm kosovar. Pra, sipas përkrahësve të “kombit kosovar”, Kosova duke e shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe duke e ndërtuar shtetin sipas premisave multietnike, faktikisht e ka shpallur edhe përkatësinë dhe pavarësinë e vet kombëtare! Duke e shpallur pavarësinë nga Serbia dhe duke u zotuar për mos bashkim me ndonjë shtet tjetër, që aludohet qartësisht në Shqipërinë (siç ka sanksionuar Antisaari në propozimin e tij), shteti i Kosovës po pretendohet të jetë qëllimi fundamental i popullit të Kosovës. Prandaj, nëse synimi i të gjithë qytetarëve qenka pavarësia si qëllim në vetvete, atëherë këta qytetarë do të përbashkohen në një identitet të ri politik që është vetë shteti i Kosovës. Në një farë forme ky “vullnet i përbashkët” do të paraqiste themelimin e “kombit politik kosovar”.

Por a është i mundur krijimi i “kombit multietnik politik kosovar”? A ka qenë synimi i përpjekjeve dhe luftës për pavarësi, që shqiptarët e Kosovës e kanë bërë për gati një shekull, që ta thelëmojnë shtetin sovran në mënyrë që më pas ta themelojnë “kombin e ri”? Apo lufta për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës nga Serbia për shqiptarët ka nënkuptuar një hap pragmatik drejt bashkimit në një shtet të vetëm kombëtar me Republikën e Shqipërisë? A kanë luftuar serbët e Kosovës për pavarësinë e Kosovës apo ata e kanë luftuar dhe e luftojnë edhe sot këtë pavarësi? Nëse Kosova e pavarur nuk është vullnet politik i serbëve pakicë, por vullnet i shqiptarëve shumicë, atëherë a mund të ndërtohet “kombi multietnik kosovar”? A ka qenë shteti i Kosovës projekt i elitës dhe nacionalizmit shqiptar dhe a e ka cenuar “pavarësia ahtisaariane” këtë projekt? A është Republika e

Kosovës shteti i dytë i shqiptarëve në Ballkan apo shtet i ri i “kombit të ri në formim”? A mund të ekzistojnë paralelisht identiteti kombëtar me identitetin shtetëror, kur ata nuk janë të njësuar me njëri-tjetrin?

Pyetjet e mësipërme paraqesin dilema dhe pretendime të ngritura në opinionin publik kosovar viteve të fundit, veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë. Në këtë ese do të synohet të argumentohet se “ideja e shtetit të Kosovës dhe realizimi i saj ka qenë projekt i elitës dhe popullit shqiptar të Kosovës, si mekanizëm për të mbrojtur, garantuar dhe kultivuar identitetin kombëtar shqiptar të Kosovës, në pamundësi të përkohshme për t’u bashkuar në një shtet unik kombëtar shqiptar. Po ashtu, ky hulumtim do të dëshmojë se idetë mbi “shoqërinë apo identitetin multi-etnik kosovar” janë improvizime dhe konstruksione të pamundshme, të cilat bien ndesh qoftë me principet teorike të formimit të identiteteve kombëtare, qoftë me rrethanat historike e politike të përpjekjeve të kosovarëve (shqiptarëve të Kosovës) për çlirim dhe pavarësi nga Serbia.

A ka nevojë Kosova të formësojë identitet të ri kombëtar kosovar?

E para, duhet thënë se me pranimin e të ashtuquajturit “Propozimi i Ahtisaarit” nga elita politike e shqiptarëve të Kosovës, e cila e përfaqësoi Kosovën në negociatat me Serbinë dhe Bashkësinë Ndërkombëtare për të përcaktuar ‘statusin final të Kosovës’, u bë një “kompromis i madh”, i cili e shpërfytyroi natyrën e idesë së pavarësisë dhe shtetit të Kosovës. Kjo elitë me këtë akt e devijoi rrugën e pavarësisë së Kosovës nga shtet të dytë shqiptar, në një shtet të ashtuquajtur multi-etnik, ku kombi shqiptar nuk njihet më si komb-themelues i shtetit të Kosovës, por ai reduktohet (në emër të barazisë) në një komunitet, i barabartë me komunitetet e tjera pakicë, kontributi i të cilave në masë të madhe kishte qenë armiqësor ndaj vullnetit politik të shumicës shqiptare për çlirim dhe pavarësi.

Mbi këtë bazë, është e qartë që ky devijim dhe shpërfytyrim i idesë së shtetit të Kosovës ka ndikuar që të krijohen pretendime, kryesisht nga qarqe antishqiptare, që meqë u arrit të ndalohet projekti i

“Kosovës si shteti tjetër i shqiptarëve në Ballkan”, tashmë duhet të imponohet edhe projekti i tjetërsimit të identitetit shqiptar të Kosovës. Realizimi i këtij projekti u nis fillimisht duke imponuar simbole të reja, të ashtuquajtura shtetërore, në të cilat u ndalua çdo element shqiptar. Në flamurin e Kosovës, përveç hartës së saj, nuk u përfshi asnjë element identifikues nacional i shqiptarëve, ndërkaq himni jo rastësisht u la pa tekst. E sipas Benedict Anderson-it “janë pikërisht himnet kombëtare, apo poezitë e këngët nacionale, këndimi i të cilave bën, ndër të tjera, përjetimin apo ‘imagjinimin e komunitetit’ të përbashkët, pra kombit”.¹ Kjo gjë u arsyetua me faktin që Kosova tashmë është shtet dhe shoqëri multi-etnike, prandaj ajo duhet që “karakterin e saj multi-etnik” ta shpërfaqë edhe në institucionet dhe simbolet e saj shtetërore. Sepse siç thotë edhe njohësi i shquar i çështjeve identitare, shkrimtari francez me prejardhje libaneze, Amin Maalouf, “identiteti është së pari çështje simbolesh, madje çështje dukjesh”.² Kështu, shteti i ri, simbolet të reja, identiteti i ri dhe kombi i ri! Kjo është tendenca dhe platforma mbi të cilën punojnë ata që pretendojnë krijimin e “identitetit të ri kombëtar të Kosovës”.

Tani, pyetja kryesore e cila shtrohet është: cila është aspirata e vërtetë identitare e popullit të Kosovës dhe si mund ta vlerësojmë këtë aspiratë? Apo, cila ka qenë lidhja ndërmjet idesë së pavarësisë së Kosovës dhe identitetit të popullit shqiptar të Kosovës?

Para se të trajtojë pengesat teorike të projektit për “kombin kosovar”, të cilat shpërfillen tinëzisht nga “kosovaristët”, duhet thënë që përpjekjet dhe lufta e popullit shqiptar të Kosovës për çlirim dhe pavarësi kanë qenë përpjekje dhe luftë para së gjithash për çlirim kombëtar dhe jo luftë për komb-formim. E gjithë rezistenca gati njëshekullore e shqiptarëve të Kosovës ka synuar realizimin e një të drejte e cila i ishte mohuar nga Konferencat Ndërkombëtare si ajo e Londrës (1913) dhe ajo e Parisit (1919), prandaj aspirata e tyre për çlirim, bashkim me Shqipërinë, përkatësisht për pavarësinë dhe themelimin e shtetit të Kosovës, duhen kuptuar si vazhde e procesit

¹Benedict Anderson, *Komunitete Imagjinare – Reflektim mbi origjinën dhe përhapjen e nacionalizmit* (Tiranë: 2 Lindje & 2 Perendim, 2013), 193.

²Amin Maalouf, *Identitete vrastare* (Tiranë: Onufri, 2006), 112.

komb-formues shqiptar, përkatësisht si proces komb-konsolidimi deri në formimin e shtetit unik kombëtar shqiptar. Sepse sipas teoricienit modernist të nacionalizmit Ernest Gellner, “ndjenja e nacionalizmi fyhet thellë nga shkëlja e parimit nationalist të përputhjes së shtetit dhe kombit”.³ Pra, sipas pikëpamjes moderniste të kombit dhe nacionalizmit që përfaqësohet me autoritetin e Gellnerit, kombet që ta realizojnë aspiratën e vet nacionaliste (që ta realizojnë vetveten) duhet ta krijojnë shtetin e vet kombëtar. Kombi shqiptar, sikur të gjitha kombet e lira të Evropës dhe Botës ka aspiruar krijimin e shtetit të vet kombëtar, i cili do të përfshinte brenda kufijve të vet të gjithë pjesëtarët e vet që kanë jetuar në ato troje historikisht. Fakti që shteti kombëtar i 1912 nuk u njoh nga Fuqitë e Mëdha dhe u copëtua nga shtetet fqinje ballkanike, nuk do të thotë që kombi shqiptar u reduktua në ata kufij territorialë që iu caktuan Republikës së Shqipërisë.

Në këtë vazhdë të komb-formimit shqiptar pas 1912 e tutje, përkatësisht të komb-konsolidimit të pjesës së kombit shqiptar të mbetur jashtë shtetit kombëtar të shpallur në Kuvendin e Vlorës, ideja e pavarësisë dhe shtetit të Kosovës përbën ide të nacionalizmit shqiptar, e cila u projektua më konkretisht nga elita politike dhe intelektuale e Kosovës gjatë viteve 1990-të, si hap më pragmatik kundrejt lëvizjeve të tjera nacionaliste të Kosovës të cilat luftonin vetëm për bashkim kombëtar (e njohur si “Ilegalja”). Projekti i pavarësisë së Kosovës nga Serbia, i cili fillimisht u synua të realizohet përmes aspiratës për barazi të Kosovës me njësitë e tjera federative të Federatës së atëhershme Jugosllave, e pastaj me shkëputje e sovranitet të plotë nga kjo federatë, nuk ishte projekt me pretendime komb-formuese “kosovariste”. Shteti i Kosovës u bë domosdoshmëri për të mbrojtur, garantuar dhe kultivuar identitetin kombëtar shqiptar të Kosovës, i cili gjatë gjithë shekullit XX-të u synua të zhdukej përmes formave klasike të kolonizimit, aparteidit dhe spastrimit etnik të shqiptarëve të Kosovës nga politika shtetërore e Serbisë.

Prandaj, jo gjithëherë njësia politike i përgjigjet aspiratave të një kombi, veçanërisht kur kjo njësi politike nuk është rezultat i

³Ernest Gellner, *Kombet dhe Nacionalizmi* (Prishtinë: Rizoma, 2009), 221.

vetëvendosjes, por është imponim i forcave pushtuese apo rrethanave gjeopolitike globale. Sikurse jo gjithherë njësia e re politike nënkupton edhe formimin e identitetit të ri kombëtar. I tillë ka qenë rasti i kombit shqiptar, një shekull pas pavarësisë dhe vetëvendosjes kombëtare, ai ka qenë në proces të përmbushjes së këtij parimi qenësor për kombet, formimin e shtetit unik kombëtar shqiptar. Pjesa tjetër e kombit e cila mbeti jashtë shtetit kombëtar të 1912, natyrisht imponueshëm, u bë pjesë e njërive të tjera politike-pushtuese, veçanërisht Serbisë-Jugosllavisë. Por të qenurit nën njësi tjetër politike, jo vullnetshëm, nuk do të thotë që identiteti kombëtar duhet t'i përshtatet asaj njësie politike. Në fakt, ky ka qenë synimi i Serbisë në Kosovë, që shqiptarët të formësojnë një identitet tjetër kombëtar, sa më të ndryshëm prej atij të Shqipërisë. Proklamimi i "identitetit jugosllav", përkatësisht dallimi i qëllimshëm që Serbia iu bënte shqiptarëve të Kosovës nga ata të Shqipërisë si "siptari" për të parët dhe "albanci" për të dytët, ka synuar të bëhej "për të penguar orientimin politik të shqiptarëve të Kosovës nga Shqipëria",⁴ si dhe për të "ngjizur" farat e një identiteti të ri kombëtar joshqiptar të Kosovës.

Gjithashtu, pavarësisht se një pjesë e mirë e elitës politike dhe kulturore e Kosovës si krahinë jugosllave (paraardhësit e kosovaristëve), duke u shkolluar e socializuar në kryeqendrat e ish Jugosllavisë si Beogradi, Zagrebi, Sarajeva etj., kishin krijuar bindjen që kombet dhe popujt e kësaj ish federate mund të shkriheshin nën "identitetin e përbashkët jugosllav" e kështu duhej të bënin edhe shqiptarët e Kosovës, në fakt është pikërisht dygjuhësia e formimit intelektual e pjesës tjetër dominante të elitës intelektuale shqiptare të viteve 1970-të e 1980-të ajo që do të ndihmonte në fuqizimin e vetëdijes për nevojën e rizgimit kombëtar të shqiptarëve të Kosovës. Është pak a shumë ajo që B. Andersoni shkruan te "Komunitete Imagjinare" për rolin që dygjuhësia e elitave intelektuale të vendeve

⁴Oliver Jens Schmitt, *Kosova – histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike* (Prishtinë: KOHA, 2012), 181.

të kolonizuara kishte luajtur në formimin dhe rizbulimin e identiteteve kombëtare të këtyre vendeve dhe luftërave për çlirim.⁵

Argument tjetër se njësia politike jo domosdoshmërisht bëhet bazë për formimin apo ndryshimin e identitetit kombëtar, është edhe fakti që shqiptarët e Kosovës e kishin njësinë e tyre politike në formë të krahinës autonome edhe nën Jugosllavi, por aspiratat e tyre për avancimin e statusit të kësaj njësie nga krahina në republikë nuk u bë sepse synonin që duke e avancuar autonominë e njësisë të formësonin ndonjë identitet të ri kombëtar. Ishte pikërisht e kundërta, republika synohej sepse kështu forcohej, promovohet dhe garantohej identiteti kombëtar shqiptar i Kosovës në nivel të barabartë me kombet e tjera të Jugosllavisë. Pikërisht identifikimi i kërkesave për republikë me mbrojtjen dhe kultivimin e identitetin kombëtar shqiptar të Kosovës, ishte arsyeja pse Kosovës iu mohua ky avancim në Federatën Jugosllave, madje iu rrënuar edhe autonomia. Kombi shqiptar në Jugosllavi ishte “reduktuar” në nivel të “kombësisë” ose “pakicës kombëtare” (narodnosti) në Jugosllavi, pra pa të drejtën e vetëvendosjes për të pasur njësinë politike sovranë në Jugosllavi, sepse konsiderohej që shqiptarët (si “pakicë”) e kishin një shtet vetin kombëtar (Republikën e Shqipërisë), prandaj s’mund ta kishin një të dytë, në këtë rast Republikën e Kosovës, si shtet të dytë shqiptar brenda Federatës Jugosllave. “Shqiptarët në Jugosllavi u trajtuan si pakicë kombëtare, edhe pse ishin kombi i tretë në Jugosllavi pas serbëve dhe kroatëve”⁶.

Kështu, edhe pse (ri)shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, duket si akt i shprehjes së vullnetit politik të popullit të Kosovës, imponimi i natyrës së shtetit të Kosovës, si shtet multi-etnik, përbën po aq pengesë dhe ndalesë në promovimin e identitetit kombëtar shqiptar të Kosovës, njësoj si atëherë kur ky ndalohej dhe pengohej nga Serbia-Jugosllavia. “Shteti kosovar i Ahtisaarit” e lejon promovimin e identitetit shqiptar të Kosovës vetëm në nivel privat e jopolitik, ndërkaq në nivel shtetëror e institucional ai ka kërkuar që

⁵Benedict Anderson, *Komunitete Imagjinare – Reflektim mbi origjinën dhe përhapjen e nacionalizmit* (Tiranë: 2 Lindje & 2 Perendim, 2013), 157.

⁶Gazmend Zajmi, *Vepra 1* (Prishtinë: ASHAK, 1997), 19.

simbolet shtetërore “të përfaqësojnë karakterin multi-etnik të shoqërisë kosovare”! Në fakt ky kusht nuk do të përbënte problem, nëse do të lejohej që vërtet në simbole të përfaqësohej identiteti “multi-etnik” për aq sa është multi-etnike shoqëria kosovare: ato simbole do të përmbanin 90% elemente identifikuese kombëtare shqiptare dhe 10% elemente identifikuese të pakicave kombëtare serbe, boshnjake, turke, rome, ashkallie, egjiptase të Kosovës. Por nuk ka ndodhur kështu, simbolet që u imponuan, në pamje nuk e përfaqësojnë askë kombtarisht në Kosovë, por në thelb e mohojnë veçanërisht identitetin e shumicës kombëtare shqiptare të Kosovës, duke qenë se ideja e Kosovës së pavarur ishte ide dhe përpjekje e popullit shqiptar të Kosovës për të zgjidhur çështjen e pazgjidhur shqiptare në Ballkan.

Me “Pakon e Ahtisaarit” minoriteteve u garantohet ruajtja dhe kultivimi i identitetit të tyre kombëtar, veçanërisht serbëve, të cilët janë kombi më i njohur politikisht e institucionalisht në Kosovë (si në raport me shumicën ashtu edhe me pakicat e tjera), ndërkaq shumica (shqiptare) nuk përmendet askund. Kur bëhet fjalë për popullin e Kosovës, pra ku duhet të vihet në pah fakti se Kosova është 90% shqiptare, thuhet “të gjitha komunitetit e Kosovës”. Pra, kjo është formula mbi të cilën synohet promovimi i “identitetit kosovar”, si identiteti i ri kombëtar i Kosovës, por kjo vetëm kundrejt shqiptarëve të Kosovës e jo edhe ndaj pakicave kombëtare të cilat e kanë të garantuar kultivimin dhe mbrojtjen e identitetit të tyre.

Atëherë shtrohet pyetja: si dhe pse të formohet kombi kosovar kur popujt pakicë qenkan të mbrojtur në kultivimin e identiteteve përkatëse kombëtare? Pra “kombi kosovar” duhet të krijohet vetëm nga shqiptarët e Kosovës?! Por pse? Për çfarë luftuan shqiptarët e Kosovës, që ta mbronin identitetin shekullor që po u cenohej me zhdukje, apo që të formonin identitet të ri kombëtar? Nëse synimi do të ishte ky i dyti, atëherë s’do të kishte luftë fare, sepse edhe vetë politika e Beogradit kishte synim që në Kosovë të krijohesh një identitet i ri kombëtar, çfarëdo qoftë ai, identitet kosovar, identitet mysliman, por vetëm identitet kombëtar shqiptar të mos ishte!

“Kombi kosovar” si paragjykim, keqkuptim dhe fobi

Pavarësisht kësaj që u tha, në Kosovë ka opinionistë e publicistë të cilët mendojnë se identiteti kosovar duhet të formësohet (1)për shkak të dallimeve që ekzistojnë ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë, (2) për shkak se duke e themeluar shtetin e pavarur, populli i Kosovës duhet të formojë edhe identitetin kombëtar dhe (3) se çdo aspiratë për ta bashkuar Kosovën me Shqipërinë, si fazë e përplotësimit të nacionalizmit shqiptar dhe e realizimit të vetëvendosjes, do të shkaktonte pakënaqësinë e shteteve fqinjë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Pra sipas tyre, “kombi kosovar” do të ishte një komb me bazë etnike shqiptare, por me karakteristika dalluese të identifikuar me gegërishten si gjuhë, ekzistencën e shtetit kosovar dhe “vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare” (lexo: albanofobisë së shteteve fqinje).

Sa i përket motivit të parë të ‘kosovaristëve’, se “kombi kosovar” duhet të formohet sepse paska dallime “të mëdha” mes shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë, duhet thënë që përveç se si i tillë është i ngjashëm me synimin e Serbisë për t’i theksuar sa më shumë dallimet ndërmjet shqiptarëve, në mënyrë që ta ç’identifikoj Kosovën me shqiptaren, në thelb edhe sikur të ekzistonte një dallim i tillë, ky motiv do të ishte më shumë paragjykim se sa motiv i mjaftueshëm për të themeluar një komb të ri e substancialisht unik. S’ka dyshim se prej atëherë kur më shumë se gjysma e kombit shqiptar mbeti jashtë shtetit kombëtar të 1912-ës, për një shekull janë zhvilluar dy realitete të ndryshme socio-politike e kulturore të shqiptarëve brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe kjo ka krijuar diferenca specifike mes këtyre dy realiteteve, kryesisht për shkak të mungesës së komunikimit. Por këto diferenca nuk janë të asaj përmase sa të ndikonte që shqiptarët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë të mos e njihnin më njëri tjetrin dhe të shihnin tek njëri tjetri më shumë elemente dalluese se sa elemente përbashkuese.

Diferenca sociale, ekonomike e madje edhe kulturore ka edhe në shoqëritë shumë më të konsoliduara kombëtarisht se sa kombi shqiptar, por kjo nuk është premisë nxitëse që çdo sub-identitet kombëtar të motivohet për t’u shkëputur nga identiteti komplementar

që i ka formësuar kombet dhe shtetet kombëtare. Nëse po ekzistuan dallime specifike ndërmjet shqiptarëve të trevave të ndryshme si pasojë e ndarjes së tyre që prej 1913-ës, atëherë shumë më i logjikshëm dhe më i lehtë është procesi i forcimit të kulturës kombëtare, e cila ka bazë historike, gjuhësore e kulturore, se sa ndërmarrësia politike e themelimit të “kombit të ri kosovar”. Të gjitha kombet në procesin e tyre të komb-formimit kanë pasur diferenca specifike brenda shoqërive të tyre, të shtrira në treva shumë më të mëdha e më të largëta se sa madhësia dhe largësia e trevave shqiptare, por siç thotë teoricieni i nacionalizmit Anthony D. Smith, shtetet kombëtare pas themelimit e ndërtojnë identitetin dhe kulturën unike kombëtare përmes politikave shtetërore-kombëtare të “arsimit publik, medias dhe politikave social-kulturore”.⁷

Nëse deri më tani kombi shqiptar e ka ruajtur ndjenjën e përbashkësisë mbi bazën e historisë, etnisë, gjakut e miteve të përbashkëta, siç bëjnë të gjitha kombet etnike, tani është koha dhe mundësia që në procesin e komb-konsolidimit të fuqizohet kultura kombëtare si proces modern i aplikuar nga të gjitha shtetet kombëtare evropiane. “Vepra e ndërtimit identitar e nisur në fund të shekullit XVIII dhe që ka lejuar ardhjen e kombeve jo vetëm nuk përfundon me përgjithësimin e shteteve-kombe, por ajo intensifikohet dhe sistematizohet”.⁸ Pra procesi i formësimit dhe konsolidimit të identitetit dhe kulturës kombëtare është proces pothuajse konstant dhe i pandalshëm.

Sa i përket motivit të dytë të kosovaristëve, se themelimi i njësisë politike, pra shtetit, çon kah themelimi i kombit, si parim bie ndesh veçanërisht edhe me teorinë e komb-formimit, sepse siç dihet kombet formohen edhe para themelimit të shtetit dhe shteti themelohet pikërisht në emër të kombit dhe për interes të tij (rastet dominante të kombeve etnike-kulturore). Madje siç u tha edhe më lart, sipas Gellnerit, kjo paraqet aspiratën themelore të çdo kombi modern, i cili

⁷Anthony D. Smith, *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale* (Tiranë: Botimet DUDAJ, 2010), 104.

⁸Anne-Marie Thiesse, *Krijimi I identiteteve kombëtare – Evropa e shekujve XVIII-XX* (Pejë: Dukagjini, 2004), 296.

duhet të krijojë shtetin kombëtar në kufijtë e kulturës kombëtare. Shumica e kombeve etnike evropiane janë formuar para themelimit të shtetit kombëtar. Ndërkaq edhe ato kombe politike apo qytetare të Evropës, si kombi francez apo kombi anglez, edhe pse konsiderohen “kombe qytetare”, kultura e tyre kombëtare është e mbizotëruar totalisht nga etnia kryesore. Siç thotë Smithi, kombet civile nuk janë tolerante siç propagandohen, “sepse nacionalizmi civil, si çmim për qytetarinë dhe përfitimet që ajo sjellë me vete, shpesh kërkon dorëzimin e bashkësisë dhe të individualitetit etnik, ‘privatizimin’ e fesë etnike dhe mënjanimin e kulturës dhe trashëgimisë etnike të pakicave brenda kufijve të shtetit kombëtar”.⁹ Kurse në rastin hipotetik të “kombit politik kosovar”, mundësia e dominimit kulturor të shqiptarëve si etnia mbizotëruese e Kosovës është përjashtuar dhe ndaluar plotësisht (nga Ahtisaari). Pra, “kombi kosovar” kryekëput nënkupton tjetërsim të identitetit historik, etnik e kulturor shqiptar të Kosovës.

Dilema e tretë e “kosovaristëve” ka të bëjë me “rreziqet e destabilitetit rajonal dhe ndërkombëtar” në rast se shteti i Kosovës e ndryshon kahen në të cilën e kanë vendosur: kahje de-shqiptarizuese. Ky paragjykimin se “nëse Kosova deklarohet si shtet kombëtar shqiptar dhe që aspiron bashkimin e vet me Shqipërinë, do ta destabilizojë rajonin”, në fakt me shumë se dilemë është fobi, ose “vesi i mbijetesës”, karakteristik për shqiptarët, të cilët historikisht vetëm kanë mbijetuar përballë planeve dhe aspiratave të të tjerëve (fqinjëve shovinistë), duke mos realizuar asnjëherë atë që është dinjiteti i një kombi (themelimi i shtetit kombëtar). Duke ia mohuar popullit autokton shqiptar të Kosovës të drejtën për të pasur shtetin e dytë shqiptar dhe bashkimin kombëtar me shtetin amë, kosovaristët justifikojnë propagandën që popullit të Kosovës i është lejuar e drejta që të “gjallojnë” në Kosovë, por territori, toka dhe gjithçka në të i takojnë Serbisë, si shtet që Kosovën e propagandon si “djep të kombit serb”. Kjo do të thotë mohim i të drejtës së vetëvendosjes së një populli i cili i ka karakteristikat e të gjithë popujve të lirë që e

⁹Anthony D. Smith, *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale* (Tiranë: Botimet DUDAJ, 2010), 114

ushtruan dhe luftuan për të drejtën e vetëvendosjes. Sepse kombet e lira nuk do të realizonin kurrë të drejtën e tyre për të vendosur për fatin e vet dhe për të krijuar shtetet e veta kombëtare nëse kjo do të varej nga vullneti i shteteve fqinje. Ky mentalitet varësie i kosovaristëve e koncepton “kombin kosovar” si të krijuar dhe të varur nga vullneti antishqiptar i shteteve fqinje.

Refleksione përfundimtare

Ideja e “kombit kosovar” është ahistorike, sepse: 1. shpërfillë faktin që populli i Kosovës ka qenë dhe është pjesë e kombformimit-kombkonsolidimit shqiptar; dhe 2. nuk mund të pretendohet formimi i një kombi të ri (krejtësisht të ri) në fillim të shekullit XXI-të, kur kombet kanë hyrë në shekullin e katërt të modernitetit. Si rrjedhojë ideja e “kombit kosovar” bëhet edhe ide ateorike sepse kombi si fenomen modern tiparet dhe standardet i ka formësuar në shekullin XVIII-të dhe XIX-të, ndërkaq shekulli XX-të më shumë se nga krijimi i kombeve të reja, karakterizohet nga procesi i komb-konsolidimeve dhe formësimi i shteteve kombëtare të atyre kombeve që nuk ishin çliruar dhe nuk kishin krijuar ende shtetet e veta kombëtare. Ndërkaq, shekulli XXI mbetet të shihet nëse do jetë shekull i dominimit të politikës botërore nga kombet moderne (etnike e qytetare) apo nga mekanizmat dhe organizatat supranacionale. Por ajo që duket të jetë e sigurt deri më tani, shekulli XXI nuk do të prodhojë standarde, kritere apo tipe të reja për kombe që do të lindin tash e tutje, që ndoshta nuk do të quheshin as kombe, por “diçka postmoderne”. Diçka postmoderne duket të jetë edhe “ideja e kombit kosovar”, por assesi realiteti kombëtar i Kosovës.

Sipas Anne-Marie Thiesse, që një komb të jetë i denjë për këtë emër duhet të ketë të plotësuar një listë përbërësish simbolikë e materialë si: “një histori që vendos vazhdimësinë me paraardhësit e mëdhenj, një seri heronjsh modele të virtyteve kombëtare, një gjuhë, disa monumente kulturore, një folklor, vende historike dhe një peizazh tipik, një mendësi e veçantë, disa përfaqësime zyrtare – himn dhe flamur – dhe disa veçori identifikuese piktoreske – veshje, gatime

karakteristike ose kafshë emblematike”.¹⁰ Pra, edhe po t’i marrim veç e veç apo të gjitha së bashku elementet e kësaj liste, do të ishte e pamundur të sajoni ndonjë “identitet kombëtar kosovar”, sepse të gjitha këto elemente të Kosovës janë identifikuar gjithnjë si elemente përbërëse të kombit shqiptar. Përjashtoj flamurin dhe himnin aktual të Kosovës, me të cilin identifikohen administrativisht vetëm institucionet shtetërore dhe elitat politike shqiptare të cilat e devijuan idenë e shtetit të Kosovës, faktikisht në Kosovë nuk mund të gjejmë asnjë element autentik i cili nuk do të mund të identifikohet si shqiptar, por si kosovar, d.m.th as si serb (meqë serbët pretendojnë që “në Kosovë e kanë djepin e tyre kulturor”!).

Vazhdimi i përpjekjes së kosovaristëve brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore kosovare për ta ç’identifikuar Kosovën nga tiparet e saj kombëtare Shqiptare, do ta bëjë shtetin e Kosovës gjithnjë e më të huaj për popullin e saj shumicë. Nëse shteti i Kosovës nuk do të përfaqësojë, garantojë dhe kultivojë identitetin historik të popullit të saj shqiptar, atëherë kjo republikë do të jetë njësi e papranueshme politike për shqiptarët siç ishte njësi politike e Krahinës Autonome të Kosovës nën ish Jugosllavi. Një komb me dinjitet nuk ndalon përpjekjet e tij derisa njësi politike nuk t’i përgjigjet aspiratave të tij. Kështu, procesi për ribërjen e shtetit të Kosovës do të jetë domosdoshmëri që shqiptarët e Kosovës ta mbrojnë identitetin e tyre historik kombëtar.

“Identiteti kosovar” s’është tjetër veçse identitet shqiptar i Kosovës, pra një sub-identitet shqiptar dhe i tillë ka qenë gjithnjë. Pretendimi për të ndërtuar “kombin kosovar” mbi karakteristikat e identitetit kosovar është i pamundur, sepse Kosova është një nga ikonat identitare të kombit shqiptar. Projektioni i “kombit kosovar” nuk ndërtohet mbi një identitet, por synon të tjetërsojë një identitet historikisht të formësuar, siç është identiteti shqiptar i Kosovës. “Kombi kosovar” dhe “identiteti kosovar” janë dy fenomene krejt të ndryshme: i pari është plan (i Serbisë) për pamundësimin e realizimit të shtetit shqiptar të Kosovës, e i dytë është identiteti shqiptar i

¹⁰Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare – Evropa e shekujve XVIII-XX* (Pejë: Dukagjini, 2004), 12-13.

Kosovës. Deri atëherë kur identiteti shqiptar i popullit, gjeografisë dhe historisë së Kosovës nuk do të jetë edhe identiteti i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, nuk do të mund të themi që çështja e Kosovës, si pjesë e çështjes së pazgjidhur shqiptare në Ballkan, është zgjidhur. Në një formë apo në një tjetër populli i Kosovës do të kërkojë rindërtimin e shtetit derisa ai t'i përshtatet përfytyrimit dhe pasqyrit të identitetit kombëtar shqiptar. Ndoshta kjo do të jetë Republika e Tretë e Kosovës.

Bibliografia

Anderson, Benedict: *Komunitete Imagjinare – Reflektim mbi origjinën dhe përhapjen e nacionalizmit*. Tiranë: 2 Lindje & 2 Perendim, 2013.

Gellner, Ernest: *Kombet dhe Nacionalizmi*. Prishtinë: Rizoma, 2009.

Maalouf, Amin: *Identitete vrastare*. Tiranë: Onufri, 2006.

Schmitt, Oliver J.: *Kosova – histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: KOHA, 2012.

Smith, Anthony D.: *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale*. Tiranë: Botimet DUDAJ, 2010.

Thiesse, Anne-Marie: *Krijimi i identiteteve kombëtare – Evropa e shekujve XVIII-XX*. Pejë: Dukagjini, 2004.

Zajmi, Gazmend: *Vepra 1*. Prishtinë: ASHAK, 1997.